
KADARE'S REVIVED LEXICON – A STEP TOWARDS THE LITERARY LANGUAGE

Luljeta Adili-Çeliku

SEEU- Tetovo, Macedonia, l.adili@seeu.edu.mk

Abstract: beautiful dialectic and regional words, old words forgotten by many which he revives in his works. Kadare is amongst those authors that have contributed a lot with their input in the unified lexicon of our language using the inexhaustible source of folk words. These words in particular represent the object of this study and they include words from both Albanian dialects, which the author has used in his works in order to make it possible for them to be inserted in the Albanian dictionary. Based on the analysis of words, i.e. Kadare's dialectisms and regionalisms, we can see that he brings words from both the Gheg dialect and the writing tradition of Gheg authors and the Tosk dialect and the writing tradition of Tosk authors; another portion of these words have been acquired through a "filter" of spelling equalization (flattening) with today's norms of standard Albanian. Three are the usage aims of dialectisms by Kadare: language-cleansing, stylistic and synonymous.

These types of words in Kadare's works are in a great number and belong to different grammatical categories. We will present only the collected nouns from some of his works. The selection criterion was determined based on whether they are simple or derivative words and we have given their semantic meaning in brackets, along with the region or dialect they derive from (this kind of explanation has not been given in all of them), as well as the aim of their usage.

Keywords: word, dialectic, regional, nouns, revival.

LESIKU I RINGJALLUR I KADARESË NJË HAP DREJT GJUHËS LETRARE

Luljeta Adili-Çeliku

SEEU- Tetovë, Maqedoni, l.adili@seeu.edu.mk

Përmbledhje: Gjuha e veprave të Kadaresë ngjall interes të madh për gjuhëtarët. Gjuha e tij është aq e pasur, me neologjizma, fjalë të bukura dialektore e krahinore, me fjalë të vjetra të gjuhës të lëna në harresë të cilat „i kthen në jetë“, shkrimtari. Kadareja radhitet në radhën e prurësve të mëdhenj në leksikun e gjuhës së unifikuar nga gurra e pashtershme e fjalëve popullore. Pikërisht këto fjalë janë objekt studimi i këtij punimi, fjalë nga të dy dialektet e shqipes të cilat shkrimtari i fut në veprat e tij për t'ua dhënë mundësinë që të futen në fjalorin e shqipes. Nga shqyrtimi i fjalëve, dialektizmave e krahinorizmave të Kadaresë, shohim se ai sjell fjalë si nga gegërishtja dhe nga tradita shkrimore e autorëve gegë ashtu edhe nga toskërishtja dhe tradita shkrimore e autorëve toskë, ndërsa një pjesë tjetër janë të përvetësuara nëpërmjet një 'filtri' të kthimit a rrafshimit drejtshkrimor me normën e sotme të shqipes standarde. Janë tri qëllimet e përdorimit të fjalëve dialektore nga Kadareja: *gjuhëpastrues, qëllimi stilistik dhe sinonimik*.

Këto lloj fjalësh në veprat e Kadaresë janë në numër të madh, iu takojnë kategorive të ndryshme gramatikore. Ne do të paraqesim vetëm emrat e mbledhur nga disa nga veprat e tij. Si kriter ndarjeje për grupimin e emrave kemi marrë atë se a janë të thjeshtë apo të prejardhur dhe në kllapa janë dhënë kuptimi apo kuptimet semantike të tyre, prejardhja nga cili dialekt apo krahinë vijnë (te disa nuk është dhënë ky sqarim) dhe qëllimi i përdorimit të tyre.

Fjalët çelës: fjalë, dialektore, krahinore, emra, ringjallje.

HYRJE

Është një strategji letrare dhe gjuhësore, nëse mund të shprehemi kështu, kur shkrimtari më i madh i një kombi, duke pasur në dorë fuqinë e pafund të shtrirjes së veprës së tij në të gjitha nivelet e lexuesve dhe të shoqërisë, iu jep edhe një shtytje fjalëve dialektore, duke dalë përtej përdorimit të zakonshëm të tyre në veprat e shkrimtarëve të tjerë. Çdo gjë është e madhe te Kadareja, çdo gjë është jashtëzakonisht ndryshe te vepra e tij dhe nga kjo mund vetëm të nxjerrim përfundim se edhe dialektizmat dhe krahinorizmat ashtu si neologjizmat e tij, qëllimi i përdorimit të tyre është i përmasave më të mëdha, dhe këtë ka për ta vërtetuar gjuha shqipe në kohërat e ardhshme.

Në sasinë e përgjithshme të fjalëve dialektore dallohen më shumë disa grupe e klasa, përmendja e të cilave jo vetëm do të zbulojë disa karakteristika të leksikut të Kadaresë, por edhe do të lejojë të nxirren edhe disa përfundime të tjera.

Twelfth International Scientific Conference
KNOWLEDGE WITHOUT BORDERS
31.3-2.4.2017, Vrnjacka Banja, Serbia

Së pari në leksikon dialektor të Kadaresë hyjnë më tepër fjalë të vendit që ai me aq zell i nxjerr nga goja e njerëzve apo nga librat e mbuluar nga pluhuri për t'iu dhënë udhën e madhe, pra hyrjen në gjuhës letrare. Është e kuptueshme kjo, ngaqë qëllimi i parë dhe i fundit është fisnikërimi dhe pasurimi i gjuhës me fjalët që njihen pak ose aspak. Do të ishte punë jo fort e mençur po të fuste fjalë që nuk janë të shqipes. Megjithatë ndodh që fjalori i personazheve të kërkojë përdorimin e fjalëve të huaja dhe atëherë Kadareja përdor tek-tuk ndonjë dialektizëm që nuk është i vendit.

Së dyti, ndonjëse Kadareja ka qëmtuar fjalë nga të gjitha kategoritë leksiko-semantike, shumica e fjalëve dialektore janë emra, kryesisht emra konkretë dhe pak më rrallë ndonjë emër abstrakt. Shihet qartë se i qëllimi përdorimit të këtyre emrave është zëvendësimi i huazimeve, pra është pastrimi i gjuhës nga të tilla huazime motivi i përdorimit të tyre. Kadareja është ndoshta i vetmi shkrimtar që ka bërë një lëvizje të tillë, pothuajse revolucionare duke zëvendësuar fjalë që duket se janë të pazëvendësueshme si: *halucinacion*, *agoni*, *pretekst*, *referencë*, *ekstazë*, *masakër* etj.

Një grup të veçantë të fjalëve dialektore janë, siç thamë më lart, emra konkretë të cilët Kadareja i përdor ku për të zëvendësuar ndonjë fjalë të huaj ku për të pasuruar akoma më shumë fondin e sinonimeve. Janë fjalë të tilla si: *jastëk*, *farmaci*, *çadër*, *stol*, *tavëll*, *oxhak*, *bojlerë*, *yrnek* etj. të cilat Kadareja i zëvendëson me fjalët vendase: *nënkresë*, *barnatore*, *hijeze*, *shkamb/shkëmb*, *prushanë*, *tymtar*, *ngrohtore*, *gjedhe* etj. Mbiemrat dialektorë që rifut Kadareja janë shumica mbiemra të prejardhur që i përshtaten bukur gjuhës, si: *i dosidoshëm*, *i kahershëm*, *i kamotshëm*, etj, që, ndonjëse janë në Fjalorin e gjuhës shqipe, prapëseprapë përdorimi i tyre del i kufizuar në ligjërimin e përditshëm të të gjitha niveleve.

Së treti, po t'i ndajmë fjalët dialektore të Kadaresë në bazë të fjalëformimit të tyre, na dalin pothuajse njëjtë të përfaqësuara të gjitha llojet, si të thjeshta dhe të prejardhurat, ashtu edhe të përbërta.

Metoda e punimit

Më poshtë i kemi analizuar emrat dialektorë e krahinorë që mendojmë se janë të ringjallura nga Kadareja. Si kriter ndarjeje për grupimin e tyre kemi marrë atë se a janë të thjeshtë apo të përbëra dhe në kllapa janë dhënë kuptimi apo kuptimet semantike të tyre, prejardhja nga cili dialekt apo krahinë vijnë (te disa nuk është dhënë ky sqarim) dhe qëllimi i përdorimit të tyre.

Emra të thjeshtë

anicirë (ndot, krupë, të pështirë; fjalë e të folmes së Gjirokastrës); *bullë* (urdhëresë që ndalon stolisjen e tepruar të grave a pispillosjen e tyre; grua që stoliste nuset kur martoheshin; fjalë e mbarë shqipes); *bunacë* (mot me qiell pus në prag të shpërthimit të stuhisë) fjalë e toskërishtes jugore, vjen prej fjalës venedikase *bonazza* (qetësi e detit); *camunxë* (camunzë) (lloj fyelli i hollë dhe i shkurtër; pipëz); *caran* (gur i vatrës ku mbështeten drutë për t'u djegur); *cimbith* (mashë për zjarr, që shërben për të trazuar prushin ose për të kapur me të thëngjijtë e ndezur); *çmërs* (cipë e fortë e krijuar nga papastërtitë dhe lagështira mbi një shtresë të vjetër prej çimentoje; myshk a petë e hollë e gjelbër që zë uji amull a një mur i lagësht; e keqe e madhe pasojë e dëmshme; trajtë shumë e vjetur që ka mbërritur në ditët tona që nga koha e lashta; djegie a përvëlim); *dergjanë* (vend i veçuar ku grumbullohen kafshët e sëmura; vend karantine. Huazim nga turqishtja, që shkrimtari e përdor me kuptim stilistikor-emocional në vend të huazimit latin karantinë); *drenjë* (zog shtegtar që i ngjan thëllëzës me pendë të murrme e lara-lara, me këmbë të shkurtra dhe me mish shumë to shijshëm; shkurtë, shkurtëz; fig. vajzë a nuse e bukur); *floçkë* (gërshetëz; figurë e besimeve popullore shqiptare që përfytyrohet si një vashë e bukur që rri në ujëra e në puse); *gërfyell* (shpellë e gjatë me dalje në anën tjetër; tunel; fjalë e gegërishtes që zëvendëson fjalën llogam); *gremç* (hekur me majë të kthyer; vegsh; fjalë e gegërishtes që zëvendëson fjalën çengel); *gjedhe* (diçka që shërben si shembull për të bërë edhe të tjera; fjalë e gegërishtes me të cilën shkrimtari zëvendëson fjalët model, kallëp, yrnek); *gjirmë* (gropa e zjarrit në vatër; fjalë e të folmes së Gjirokastrës); *hokë* (shaka, shpoti; fjalë dialektore e huazuara nga turqishtja); *jeh* (kthim i zërit; jehonë; fjalë mjaft e përdorur e gegërishtes veriore); *korë* (ikonë; fjalë e toskërishtes); *log* (lëndinë e vogël zakonisht në mal a në mes të pyllit; shesh i vogël, vend i rrafshët; shesh ndeshjesh ose mejdan); *mahi* (shaka, shpoti, qesëndi); *moh* (mohim, shprehja e mospranimit a e kundërshtimit të diçkaje, e mospajtimit me diçka; mishërimi i së kundërtës së diçkaje); *ngulç/ gulç* (të zënë e frymës, sëmundje që shfaqet me të zënë e frymës; gulçimë; rrymë ajri; fig. hidhërim pikëllim; fatkeqësi, hall i madh; dëshirë e madhe, lakmi); *pahi* (gardh me hunj ose me dërrasa të holla e të gjata që mbërthehen si parmakë; trinë me purteka a me dërrasa të holla që vihet si derë); *parzëm* (krahatorë, gjoks; fjalë e toskërishtes); *plojë* (gjakderdhje, kërdi); *qokë* (gurë a diçka tjetër që vihet si shenjë ose si kufi; pikë e zgjedhur ose e përfytyruar që ndihmën për të gjetur me përpikëri një drejtim); *rrëshek* (vegël muzikore me frymë); *rrah* (tokë buke a kulotë që hapet në pyll duke prerë drurët e shkurret; fjalë e gegërishtes); *shkam/ shkëmb* (ndenjësë prej druri për një njeri e ulët dhe pa shpinëz; fjalë e gegërishtes); *shkorsë* (qilim i thjeshtë i punuar

zakonisht me lesh dhie, cergë; mbulesë e leshtë, velenxë; rrobë e thjeshtë që përdoret për të shtruar a për të mbuluar); shkulum (dallgë a valë e madhe, valë e turrshme, suvalë e detit a e lumit; valë; gulfë); vegjë (vegël e madhe prej druri me katër këmbë dhe me pajisjet e nevojshme që përdoret nga një njeri për të endur pëlthurë ose qilima; vegë; fjalë e gegërishtes që shkrimtari e përdor në vend të avlëmend apo tezgjah); zgrof (stomaku i njeriut a i kafshës); dhiatë (dëshira a porosia e fundit para vdekjes; amanet; fjalë e toskërishtes me burim nga greqishtja).

EMRA TË PREJARDHURA

angështi / angushti (rrjedh prej fjalës angësh + i; gjendje ndrydhëse që nuk të lë të mbushesh lirisht me frymë, për shkak të një frike a të një shqetësimi të madh; e mbarë shqipes); barnatore (barna (shumësi i fjalës bar) + prapashtesa -tore; farmaci; fjalë e ligjërit të përditshëm në Kosovë, me të cilën shkrimtari zëvendëson huazimin farmaci); brejë (rrjedh prej foljes brej + prapashtesës -ë; sëmundje që shfaqet me kalbjen e mishit rreth plagës, gangrenë; fig. vuajtje a mundim shumë i madh që bren vazhdimisht e shkatërron dalëngadalë; brengë gërryese; fjalë e gegërishtes me të cilën Kadareja zëvendëson fjalën gangrenë); brerimë (rrjedh prej rrënjorit brer i cili paraqet formën toske të bren-, e kjo është pjesorja e brej + prapashtesa -imë, i ftohtë, i hidhur me shi e me erë; thëllim; ciknë; acar); bujtinar (rrjedh prej emrit bujtinë + prapashtesës -nar; i zoti i bujtinës; me këtë fjalë shkrimtari zëvendëson më së shumti huazimet hanxhi, hotelier, hotelxhi); bujtje (emri prejfoljor i foljes buj / (bujt/ur + je); veprimi i atij që shkon për të bujtur te dikush; fjalë e mbarë gjuhës , ndonëse përdorim më të dendur ka në dialektin gegë; me këtë fjalë shkrimtari zëvendëson fjalën mysafirllëk); bukurezë (rrjedh prej mbiemrit bukur + ezë; xixëllonjë; buburesë; është fjalë e të folmes arbëreshe); bythec (rrjedh prej emrit bythë + prapashtesës -ec; njeri krejtësisht i paaftë; njeri pa asnjë përvojë; njeri frikakakë; homoseksual; është fjalë e gegërishtes e cila në fillim fare kishte kuptim përqekësues: djallë a burrë të cilin e merrte me vete një i ftuar në dasmë a në një festë; është ndër fjalët e ringjallura së cilës Kadareja i vesh një kuptim të ri); cytanik (rrjedh prej foljes cyt + prapashtesës -anik; që nxit për një veprim të keq; cytës; cytanar; ngatërrestar; fjalë e gegërishtes së librave me të cilën Kadareja zëvendëson fjalën provokator); dasmoreshë (dasmor + eshë; ajo që shkon ta marri nusen bashkë me dasmorë të tjerë për ta shoqëruar deri te shtëpia e dhëndrit; e ftuar në dasmë; fjalë e mbarë gjuhës); dergjë (rrjedh prej foljes dergj + prapashtesa -ë; sëmundje e rëndë, që e detyron të sëmurin të dergjet në shtrat për një kohë të gjatë; lëngatë, tuberkulozë; fjalë e mbarë shqipes së cilës shkrimtari i jep kuptim të ri nga ai që kishte me parë: sëmundje e bimëve a e frymoreve); drithnik (rrjedh prej fjalës drithë + prapashtesës -nik; arkë e madhe prej druri a prej metali që shërben për të mbajtur drithë apo miell, hambarë; fjalë e mbarë shqipes të cilën Kadareja e përdor për të zëvendësuar huazimi hambarë); drojë (vjen nga droe me ndërhyrjen e një -j-je kundra hiatit; frikë; dyshim për ndonjë të papritur të pakëndshme ; me këtë kuptim shkrimtari zëvendëson huazimin merak); dheas (vjen nga fjala dhe + prapashtesa -as; ai që është i ardhur nga një vend tjetër; ardhës, jovendës; i huaj; është fjalë e gegërishtes); dhjatës / dhiatës (vjen nga fjalë dhiatë + prapashtesa -ës; ai që lë testament; trashëgimlënësi; është fjalë e toskërishtes); emnak (vjen nga emën + prapashtesa -ak; ai që ka të njëjtin emër me një tjetër; njëemërsh; bashkemnak; është fjalë e gegërishtes të cilën shkrimtari e përdor për të zëvendësuar fjalën adash); farim (emër prejfoljor prej foljes faroj + prapashtesa -im; shfarosje me dhunë; zhbirje; fjalë e mbarë gjuhës, më dendur përdoret në dialektin e Veriut); gërmajë (shpellë a gufë në një shkëmb a në një faqe mali; zgavër e madhe e nëndheshme që hapet duke gërmuar; kalim i nëndheshëm; skutë e fshehtë; zbrazëtirë; fjalë e gegërishtes me të cilën shkrimtari zëvendëson huazimet tunel, llagëm, labirinth dhe boshllëk); gostijar (vjen nga fjala gosti + prapashtesa -(j)ar; ai që është i ftuar në një gosti; pjesëtar i gostisë; është fjalë e toskërishtes; është fjalë sllave); fërtymë (? + prapashtesa -më; vrull i fuqishëm, i shpejtë që përllan çdo gjë që gjen përpara; sulm i furishëm dhe i shpejtë; tërbim; erë e fortë e Veriut; verë; stuhitë; furtunë; fjalë e toskërishtes); fikë (vjen nga folja fik + prapashtesa -ë; shkatërrim i plotë; fatkeqësi shumë e madhe; gjëmë; fjalë e gegërishtes); flakurimë (është variant dialektor i fjalës flakërimë; shpullë e fortë; flakaresh; është fjalë e gegërishtes); flokatë / flokate (vjen nga fjala flokë + prapashtesa -atë; velenxë me thekë, flokje; është fjalë e dialektit të toskërishtes; me këtë fjalë shkrimtari zëvendëson fjalën batanije); flokëse/ flokse (vjen nga fjala flokë + prapashtesa -(ë)se; velenxë me thekë, flokje; është fjalë e dialektit të gegërishtes; me këtë fjalë shkrimtari zëvendëson fjalën batanije); flligështi/ fëlligështi (vjen nga fjala fëlligësht (i,e) (njeri i papastër, ndyracak)+ prapashtesa -i; prishje me gjak të vet; shtrembërim i formulës gjenetike të organizmit njerëzor, të shkaktuara me marrëdhënie seksuale; punë e ndyrë, e keqe dhe e turpshme; fjalë e mbarë shqipes, të cilën shkrimtari e përdor në vend të fjalës incest); frymëz (vjen nga fjala frymë + prapashtesa -ëz; pengesë në frymëmarrje që shkaktohet nga një shqetësim i fortë ose nga një lodhje e madhe; astmë; fjalë e mbarë gjuhës, me këtë fjalë shkrimtari zëvendëson fjalën astmë); ftomë / ftohmë (vjen nga fjala ftoh + prapashtesa -më; mot i ftohtë; e ftohur; të ftohta; është fjalë e toskërishtes); fundajë (vjen nga fjala fund + prapashtesa -ajë; skaji fundor i një hapësire, i një mali, i një lumi, i një

Twelfth International Scientific Conference
KNOWLEDGE WITHOUT BORDERS
31.3-2.4.2017, Vrnjacka Banja, Serbia

are, i një sendi; cep; bisht; grumbulli i rëndomtë; fig. gjendje e përgjithshme; kushtet apo mjedisi në të cilin zhvillohet a bëhet diçka, me këtë kuptim shkrimtari zëvendëson huazimin sfond); grahmëz (vjen nga fjala grahmë + prapashtesa –z; sëmundje që të godet e të merr frymën menjëherë; pika; fjalë e mbarë gjuhës); grathore (vjen nga fjala grath + prapashtesa-ore; zhgun i vjetër prej pëlhure të ashpër; brez i trashë e me që veshin murgjit e shërbyesit e fesë gjatë kohë së pendesës; fjalë e dialektit Verior); gropshar (vjen nga gropë/grapsh + prapashtesa –ar; ai që hap varre, që punon si varrtarë; vrasës kriminel; ai që bën me paramendim një të keqe dikujt, ai që dëshiron t'i bëjë të keqen dikujt; është fjalë e mbarë gjuhës); gjëmëtar/gjamëtar (vjen nga fjala gjëmë + prapashtesa –tar; ai që qan me gjëmë të vdekurin; ai që bën një ritual për të vdekurin dhe që vajton me zë e duke çjerrë me thonj fytyrën; fjalë e mbarë shqipes, ndërsa trajta gjamëtarë është trajtë e gegërishtes); gjoksore (vjen nga fjala gjoks + prapashtesa –ore; parzmore; veshje prej metali e gjatë deri në brez që mbronte luftëtarët gjatë ndeshjeve me armë të ftohta; veshje e brendshme e grave si jelek që shtrëngojnë gjoksin; historizëm); hekurinë (mashë për zjarr;duke futur në përdorim numrin njëjës të fjalës hekurinë e cila është përdorur vetëm në shumës, Kadareja krijon një kuptim të ri); hijerinë (vjen nga fjala hije + prapashtesa –inë; vend me hije, vend i ftohtë që nuk e zë dielli; hijesirë; është fjalë e gegërishtes); hijezë/ hijëz (vjen nga fjala hije + prapashtesa –z; çadër, ombrellë; shkrimtari e përdor për të zëvendësuar huazimet çadër dhe ombrellë); hinore (vjen nga fjalë hi/ni + prapashtesa –ore; enë e posaçme ku ruhet hiri i një kufome të vdekur; me këtë trajtë e të folmes gege shkrimtari huazon fjalën urnë); kalçunja (është huazim nga gjuhët neolatine; lloj çorapësh të bukura që mbanin burrat në Gjirokastrë; fjalë e të folmes së Gjirokastrës); kaptim (emër prejfoljor prej foljes kapt/oj + prapashtesa –im; veprimi dhe gjendja sipas kuptimit të foljes kapttoj; kalimi i një hapësire (mal, fush, det) me këmbë , me makinë, me aeroplan, me anije, etj.; është fjalë e mbarë gjuhës); kotni (vjen nga fjala kot + prapashtesa –ni; të qenët i kotë, të qenët pa dobi e pa vlerë; diçka e kotë, punë e kotë, gjë e kotë dhe pa vlerë; fjalë e gegërishtes që e parapëlqen shkrimtari përpara fjalës së mbarë shqipes kotësi); krahamë (vjen nga fjala krah + prapashtesa –anë; grup njerëzish që mbajnë krahun e dikujt, anë, taraf; është fjalë e gegërishtes; Kadareja e përdor këtë fjalë të vendit për të zëvendësuar huazimin fraksion); krenajë (vjen nga fjala krye/ kreu + prapashtesa –najë; maja më e lartë e një vendi, e një mali a e një kodre; ana e sipërme e një vendi; diçka që ndodhet në fillim, kreu i diçkaje; parësia, të parët e një vendi a të një lëvizjeje; fjalë e gegërishtes); kulmar kulmore (vjen nga fjala kulm + prapashtesa –ar; maja e çatisë së një ndërtese a të një tende a shatorreje; kulmi; është fjalë e mbarë shqipes); kupëz (vjen nga fjala kupë + prapashtesa –ëz; është zvogëlim i fjalës kupë; është fjalë e mbarë shqipes të cilën Kadareja e përdor për të zëvendësuar huazimin e ngulitur filxhan); lektisje (emër prejfoljor prej foljes lektis + prapashtesa –je; veprimi si dhe gjendja sipas kuptimit të foljeve lektis; mall i madh për dikë, vuajtje e thellë shpirtërore; fjalë e toskërishtes); ligatinë (vjen nga fjala lig/ë-a + prapashtesa –tinë; vend i lagësht e me barë tokë që mban gjithnjë ujë; moçalishte; është fjalë e gegërishtes); lutësore (vjen nga fjala lutës + prapashtesa –ore; libër lutjesh; fjalë e mbarë gjuhës); llogaçe (është fjalë e huazuar ; hurdhë e vogël me ujë të ndenjur); mbërtheckë (emër prej foljore prej foljes mbërthej + prapashtesa –ckë;kopsë, karficë për të kapur dy anët e një petku; diçka që shërben për të mbërthyer; është fjalë e mbarë shqipes); mbledhëtar (emër prejfoljor prej foljes mbledh + prapashtesa –tar; pjesëmarrës në një mbledhje; është fjalë e vjetruar të cilën Kadareja e ringjallë për të emëruar pjesëmarrësit në një mbledhje i çfarëdo lloji qoft); mbushulli (emër prej foljor prej foljes mbushulloj + prapashtesa –i; sasi e madhe, bollëk; është fjalë e mbarë gjuhës); mehje (emër prejfoljor prej foljes meh + prapashtesa –je; dobësim i diçkaje, pakësim i diçkaje pak nga pak derisa të soset krejt; është fjalë e gegërishtes); mekje (emër prejfoljor prej foljes mek + prapashtesës –je; këputje, lodhje, mpakje; është fjalë e mbarë gjuhës); mesore (vjen nga fjala mes + prapashtesa –ore; dhomë e vogël e hapur që ndodhet mes dhomave tjera; paradhomë; korridor; është fjalë e gegërishtes); mëkatnim (emër prejfoljor prej foljes mëkatoj + prapashtesa –im; shkel një rregull a diçka të ndaluar, bëj faj , bëj një veprim të turpshëm a të dënueshëm; Kadareja pëlqen variantin mëkatnoj përpara variantit letrar mëkattoj); mëngore (vjen nga fjala mëngë + prapashtesa –ore; këmbishë me mëngë të gjata e poshtë të gjëra; është formë e letrarizuar e fjalës gege mangore); mëtuës (vjen prej fjalës mëtoj + prapashtesës –ues; ai që kërkon me këmbëngulje të bëj diçka, që kërkon diçka sikur të ishte e tij; pretendues; më parë ka qenë fjalë e gegërishtes, tash është bërë e mbarë gjuhës); mëvetësi (vjen nga fjala mëvete + prapashtesa –ësi; të qenët më vete ; pavarësi; është fjalë e gegërishtes të cilën Kadareja e përdor si sinonim të fjalës pavarësi); mishtar (vjen nga fjala mish + prapashtesa –tar; kasap; është fjalë e mbarë gjuhës me të cilën Kadareja e zëvendëson fjalën kasap); mugullimë (vjen nga fjala mugullin + prapashtesa –imë; vendi ku ka mbirë ose kanë shpërthyer bari, lulet, sytha, etj.; fig. diçka që sapo ka filluar të shpërthejë; është fjalë e gegërishtes); ndezë (vjen nga fjala ndez + prapashtesa –ë; ndjenjë keqdashjeje për diçka më të mirë që ka tjetri, resë, smirë; gjendje shpirtërore që shoqërohet me zjarr të papërmbajtshëm, zemërim; fjalë e gegërishtes) ndezëse, (vjen nga ndez + prapashtesa- ëse; mjet ose pjesë e posaçme që shërben për t'i dhënë zjarrin diçkaje ose për të ndezur diçka; Kadareja me këtë fjalë të mbarë gjuhës

zëvendëson turqizmin çakmak); ndezulli (vjen nga folja ndez + prapashtesa -ull me zgjerimin me anë të i-së; zjarrmi, ethe; zell, dëshirë e madhe për punë; Kadareja me këtë fjalë mëton të zëvendësojë huazimin eksitim); nënkresë/ nënkrecë (nën+krye+ së), që përdoret për të mbështetur kokën a për të ndenjur mbi të; jastëk; fjalë e gegërishtes. Kadareja e përdor në vend të huazimit turk jastëk); ngrehë (folja ngreh + prapashtesa -ë; tërësia e pjesëve prej druri, prej hekuri etj., që përbëjnë skeletin e një ndërtese, skelet; fjalë e mbarë gjuhës me të cilën Kadareja zëvendëson huazimin strukturë); ngrehinë (folja ngreh + prapashtesa – inë; ndërtesë e ngritur për të vendosur makineritë , për të mbajtur prodhimet, lëndët e para etj. ose për një shërbim tjetër; diçka e ndërtuar me punë mendore; përveç këtyre kuptimeve, Kadareja kësaj fjale i ngjii edhe kuptimin e fjalës pallat duke zëvendësuar këtë të fundit; fjalë e gegërishtes librorë); ngrohtore (folja ngroh + prapashtesa -tore; mjet që shërben për të ngrohur, qoftë në industri, qoftë në amvisëri; kaldajë, bojlerë; fjalë e mbarë gjuhës, ndonëse me kuptime të ndryshme; Kadareja e përdor me qëllim të pastrimit të gjuhës, duke zëvendësuar fjalët kaldajë dhe bojlerë); njehsim (njehs/oj + prapashtesa – im; veprimi sipas foljeve njehsoj, njehsohet; tërësia e veprimeve me numra për të nxjerrë një përfundim ose për të gjetur atë që kërkohet, llogarit; përveç këtyre kuptimeve semantike, Kadareja kësaj fjalë i ngjii edhe kuptimin e fjalës së huazuar kalkuloj; fjalë e gegërishtes me bazë foljen njeh, pra numëroj); oborrësi (fjala oborr + prapashtesa – ësi; kjo fjalë është një arkaizëm të cilin Kadareja jo vetëm e përdor në kuptimet e tij të para, pra, të qenët pjesëtar i rrethit të një monarku etj, dhe sjellje e stërholluar, e hollë dhe fisnike, mirësjellje, bujari etj., por edhe për të zëvendësuar fjalën e huaj kortezi); pasunar (nga fjala gege pasun (i,e) + prapashtesa – ar; i pasur, pasanik; fjala e gegërishtes të cilën Kadareja e përdor vetëm për qëllime stilistike dhe për t'i dhënë gjuhës edhe një sinonim, pra për ta pasuruar atë); plagomë (nga fjala plagoj + prapashtesa – më; plagë që nuk ka shenja të jashtme; Dhembje a brengë e thellë dhe e fshehtë; e mbarë gjuhës, ndonëse jo shumë e njohur); pleqnar (nga fjala pleqni + prapashtesa – ar; ai që është zgjedhur si plak për punët e katundit; ai që pleqëson, plak; është fjala e gegërishtes, etnografike); prushanë (nga fjala prush + prapashtesa – anë; enë prej metali, si legen me këmbëza, ku ndihet qymyr druri ose mbahet prush për t'u ngrohur; mangall; fjalë e gegërishtes me të cilën Kadareja këmbëngulshëm zëvendëson fjalën mangall); qethtar (nga folja qeth + prapashtesa –tar; punëtor i përgatitur që u qeth flokët të tjerëve, floktar; fjalë e mbarë gjuhës të cilën Kadareja e sjell në vend të huazimit turk berber); qullni (mbiemri qull + prapashtesa - (ë)ni/ -(ë)ri ; të qenët i qullët; pazotësi, mungesë shkathtësie, plogështi; fjalë e gegërishtes siç shihet nga varianti gegë i vetë prapashtesës); radhor (nga fjala radhë + prapashtesa –or ; varg gurësh që dalin nga toka ose në një shtresë shkëmbi; gur i madh; varg që varet në qafë për zbukurim; fjalë e mbarë gjuhës të cilën Kadareja e përdor në vend të fjalës gjerdan); pretar (nga fjala pre + prapashtesa –tar; ai që bën pre në gjë të gjallë të tjerëve; plaçkitës , hajdut; fjalë e mbarë gjuhës me të cilën Kadareja kërkon të zëvendësojë fjalën hajdut dhe të pasurojë akoma me tej shqipen); rragatë (nga folja rragatem + prapashtesa – ë; grindje me fjalë, zënie; fjalë e mbarë gjuhës; Kadareja e përdor në vend të huazimit turk sherr); rrëmet (rrymë uji që vjen me rrëmbim; njerëzit, gjindja, turmë njerëzish; fjalë e mbarë gjuhës e cila parë nga ana fonetike është shumë e goditur për të shprehur kuptimin e një turme të madhe me njerëz , ndoshta për shkak të rr-së dhe të cilën Kadareja e rishpërndan ngaqë përdoret rrallë); rrokulli (nga ndajfolja rrokull + prapashtesa –i; gjithësia, rruzullimi; bota; fjalë e gegërishtes librorë të cilën Kadareja e rifut në përdorim të gjerë si sinonim i fjalës botë dhe gjithësi); shajni (? + prapashtesa –ni ; përfytyrimi i rremë që i shfaqet si hije dikujt në një gjendje të sëmurë; hije, vegulli; është fjalë e gegërishtes me të cilën Kadareja zëvendëson me këmbëngulje fjalën e huazuar halucinacion); shitore (nga pjesorja foljes shes- shit(ur) + prapashtesa – ore; fjalë kryesisht e të folmeve të Veriut të cilën Kadareja e përdor për të zëvendësuar huazimin turk dyqan); shortar (nga fjala short + prapashtesa –ar; ai që hedh fall; falltar; fjalë e mbarë gjuhës të cilën Kadareja e përdor si sinonim i fjalës falltar e cila njihet më shumë, pra thjesht për pasurimin e gjuhës); shortari (shortar + prapashtesa –i; dredhitë dhe mashtrimet që bën shortari; fjalë e mbarë gjuhës së cilës shkrimtari, përveç kuptimeve të para, i ngjii edhe kuptimin e fjalës së huazuar profeci); shpartallinë (nga shpartall- shpartalloj + prapashtesa – inë; ndërtesë a diçka tjetër e vjetër dhe e shkatërruar; shkatërrinë; fjalë e gegërishtes të cilën Kadareja e ka futur në përdorim si për qëllime stilistike ashtu edhe për të pasuruar gjuhën); shpërbetar (nga folja shpërbej + prapashtesa - tar; ai që bën be të rrejshme; fjalë e mbarë gjuhës të cilën Kadareja e përdor si sinonim të fjalës i berrejshëm); tëmotje (sende ushqimore që përgatiten a grumbullohen për të ruajtur për një kohë të gjatë dhe për tu përdorur më vonë, zakonisht në dimër; zahire); tymtar (nga fjala tym + prapashtesa –tar; fjalë e mbarë gjuhës me të cilën shkrimtari me të drejtë zëvendëson fjalën e huazuar oxhak); vegulli (nga folja vegull/oj + prapashtesa –i; diçka që na përfytyrohet në vetëdije pa e kapur me anë të shqisave; përhitje; përfytyrim i çastit i dikujt a i diçkaje; ëndërr; është fjalë e gegërishtes të cilën Kadareja me ngul mundohet ta futë si zëvendëse të fjalës halucinacion); vigmë (nga folja vikas + prapashtesa –më. klithma që nxjerr njeriu në rast fatkeqësie nga dhembja që ndien etj.; britmë e madhe , sokëllimë); vrajë (gjurma që lë një plagë në trup a në lëkurë; pullë e errët që bëhet në lëkurë kur përpiqemi diku,

Twelfth International Scientific Conference
KNOWLEDGE WITHOUT BORDERS
31.3-2.4.2017, Vrnjacka Banja, Serbia

vurratë); zgjumth (gjumës, barë që të vë në gjumë, gjumëdhënës; fjalë nga e folmja e arbërishtes); veshull (nga fjala veshull + prapashtesa -i; të qenët veshullor, të qenët i ngjithshëm; fjalë e mbarë gjuhës me të cilën Kadareja përshkruan një gjendje të përzier); zhabëllimë (variant dialektor i fjalës zhapëllimë; zhurma që bëjmë kur ecim mbi gjethe të thata, mbi xhama të thyer etj);

PËRFUNDIMI

Shtresa më e gjerë e fjalëve dialektore e krahinore përbëhet nga ato fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si sinonime leksikore të fjalëve më të përgjithshme a të dialektit tjetër, duke sjellë jo vetëm larmi, por edhe pasurim me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionale etj. Kjo bën prirje që gjuha letrare të mos shkëputet nga baza e saj popullore, tek e cila mbështetet që nga fillimet e saj. Kjo dukuri vrellin më të madh e pati në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të. Ajo e lehtësoi dhe e shpejtoi njësimin e gjuhës letrare kombëtare, duke sheshuar çdo gardh e paragjykim lokalist e regjionalist, duke vlerësuar si parësor në formimin e gjuhës letrare kombëtare faktorët gjuhësorë, kurse kushtet shoqërore si ndihmës të këtyre faktorëve. Kjo i dha gjuhës letrare shqipe të sotme një taban të shëndoshë popullor, gjë që lehtësoi jo vetëm formimin e saj, siç u tha, por edhe shtrirjen në gjerësi në një kohë të shkurtër.

Kadareja radhitet në radhën e prurësve të mëdhenj në leksikon e gjuhës së unifikuar nga gurra e pashtershme e fjalëve popullore. Ai sjell fjalë nga gjitha vendet shqipfolëse. Këtë e bën për shumë arsye, disa prej të cilave i përmendëm që ne fillim siç janë pastrimin dhe pasrimi i gjuhës. Por një arsye tjetër është shuarja e zërave të cilat flasin se i është bërë padrejtësi dialektit verior kur u unifikuar gjuha shqipe në 1972, dhe se shumë fjalë të bukura të këtyre anëve ngelen pa mos u përfshirë në gjuhën letrare. Kadare i fut në veprat e tije për t' u dhënë famën, për t' i popullarizuar.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- [1] Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë, 1973
- [2] Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë, 1976
- [3] Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Fjalori i gjuhës shqipe. Tiranë, 2004
- [4] Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë, 1995
- [5] Çausi, Tefik dhe Gjovalin Shkurtaj. Kadareja dhe fjala shqipe. Tiranë: Albas, 2004
- [6] Sotiri, Natasha. Fjalori i gjuhës së Ismail Kadaresë. Tiranë: Medaur, 2007
- [7] Thomai, Jani. Leksikologjia e gjuhës shqipe. Tiranë: Botimet Dudaj, 2005
- [8] Vëllimet e veprës së Kadaresë nga Shtëpia Botuese 'Fayard'

Veprat e Kadaresë

- [1] VEPRË, vëllimi i parë, Paris, 1993
- [2] VEPRË, vëllimi i dytë, Paris, 1994
- [3] VEPRË, vëllimi i tretë, Paris, 1995
- [4] VEPRË, vëllimi i katër, Paris, 1996
- [5] VEPRË, vëllimi i pestë, Paris, 1997
- [6] VEPRË, vëllimi i gjashtë, Paris, 1998
- [7] VEPRË, vëllimi i shtatë, Paris, 1999
- [8] VEPRË, vëllimin i tetë, Paris, 2000
- [9] VEPRË, vëllimi i nëntë, Paris, 2001